



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Raport monitorues XI-të

**mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit**

Maj 2015

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Dinamika e punës së Kuvendit,
- NOTIMI,
- TRENDI I DISKUTIMEVE,
- ÇËSHTJET E INICIUARA,
- PYETJET E PARLAMENTARE,

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan
Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>
<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Hyrje


Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të njëmbëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it



Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'u ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar-Maj 2015. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendi.

Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me të gjeturat dhe përgjegjësitë e Komunës. Nga të gjeturat e monitorimit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Kjo periudhë Janar-Maj 2015 karakterizohet me një angazhim konkrete të deputeteve me pyetje dhe ngritje të çështjeve drejtuar ekzekutivit. Ku gjatë kësaj periudhe kemi mbi 30 pyetje drejtuar ekzekutivit dhe janë ngritur 9 çështje konkrete të problemeve që ballafaqohen qytetarët e Komunës së Lipjanit. Është interesante se të gjitha këto pyetje dhe shqetësime të deputetët e Kuvendit Komunal të Lipjanit nuk marrin përgjigje adekuate nga ana e ekzekutivit, me përjashtim të mbledhjes së 17-të ku ishte prezent kryetari i komunës dhe dha përgjigje ndaj pyetjeve të bëra nga deputetët. Ekzekutivi i komunës është i obliguar që të ju përgjigjet deputetëve në rast të parashtrimit të pyetjeve, për mos përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara nga deputet kemi të bëjë me shkelje të ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 të datës 20 shkurt 2008, të nenin 39. Ku ka të bëjë me të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit të komunës, pika 2, ku thuhet citojmë: “Anëtar i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendës-kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në

pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës”. Po ashtu, kemi shkeljen e rregullores së punës të Kuvendit Komunal të Lipjanit të datës 07.11.2014, të Kapitullit VI. Ku ka të bëjë me të drejtat, obligimet e anëtarëve të Kuvendit dhe parashtrimi i propozimeve procedurale, ku në nenin 14 lidhur me të drejtat e anëtarëve të Kuvendit të komunës në pikën “e”, thuhet citojmë: “” Të kërkojnë nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e organeve të Administratës Komunale, informacione me gojë dhe me shkrim lidhur me çështjet komunale”.

- ✓ Edhe pse ka pasur iniciativë nga ana e kuvendit për ndryshim e statutit të Komunës së Lipjanit në seancën e 14-të, me datën 27. 02. 2015, por për shkak të mos sigurimi 3/4 e votave të deputeteve ende vazhdohet më tutje që të mos harmonizohet me ligjet aktuale në fuqi, ku kemi një mos përputhje në mes Statutit Komunal (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës. Statuti Komunal i Komunës së Lipjanit edhe pas ndryshimit të bërë në vitin 2013, me shtimin e tre drejtorive të reja komunale, prapa se prapë është në kundërshtim me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008, ku në bazë të këtij ligji Komuna e Lipjanit i ka 59 vendbanime dhe fshatra, ndërsa në Statutin Komunal në kapitullin II, ku ka të bëjë me vendbanimet e komunës, gjegjësisht në nenin 13. rreth vendbanimet dhe fshatrat, figurojnë 70 vendbanime dhe fshatra, që do të thotë në bazë të ligjit të lartë përmendur Komuna e Lipjanit i ka 11 fshatra më pak se sa me statutin komunal.
- ✓ Top treshja me aktive nga ana e deputetëve të kësaj legjislature për periudhën Qershor- Nëntor 2014 është: **FLORENT HOXHA** nga PDK-ja me 79 pikë **BLERIM GASHI** nga AKR-ja me 58 pikë dhe **RAMIZ QIRI** PSD 39 Pikë,
- ✓ Top 5-ta më pasive në Kuvendin Komunal për periudhën Janar-Qershor 2014 përbëhet nga deputetet: **ARTON RETKOCERI LDK 0 Pikë, NAIM JAHIRI LDK 0 Pikë, BURBUQE FAZLIU LDK 0 Pikë, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL 0 pikë dhe ADELINA KRASNIQI (ALBULENA GASHI) AKR 0 Pikë.**
- ✓ Në legjislaturën e re 2013/2017, është për tu çuditur edhe pse nuk janë paguar në mënyrë të rregullt anëtarët e komiteteve si përfaqësues të organeve të Kuvendit komunal, është rritur numri i anëtarëve në këto komitete nga 40 në 56 anëtar sa ka pasur në legjislaturën e kaluar,
- ✓ Me 20 Maj 2015, organizata Joqeveritare YAHR nëpër mes një komunikate për media ka Informuar opinionin publik, shprehur shqetësimin dhe ka reaguar ndaj ndërprerjes së dërgimit të materialeve të Kuvendit Komunal të Lipjanit për organizatën e vetme monitoruese. Pas dërgimit të rregullt gjashtë vjeçare të materialeve për seancat e kuvendit Komunal të Lipjanit për organizatën monitoruese YAHR, legjislativi i Komunës së Lipjanit e ka ndërprerë dërgimin e materialeve pa asnjë paralajmërim apo shqarim dhe me këtë veprim lundrin pyetjet dhe dyshimet se pse Komuna e Lipjanit i frikësohet me dërgimin e materialeve të kuvendit para miratimit të tij për organizatat monitoruese. Ky veprim nga organizata YAHR është vlerësuar si veprim jo i drejtë dhe që është në kundërshtim me parimet e kryetarit të Komunës së Lipjanit Z. Imri Ahmeti për “Transparencë dhe llogaridhënie” të dhëna ndaj qytetarëve në zgjedhjet lokale për kryetar komunash në vitin 2013.
- ✓ Po ashtu kemi konstatuar mos efikasitet të punëve të Komiteteve të formuara me përjashtim të komitetit për politikë dhe financa,

Rekomandimet:

- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.
- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikulimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit

Në këtë vit 2015 deri me tani janë mbajtur katër seanca plenare të rregullta, 4 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Krahasuar me vitin e kaluar është një gjendje e njëjtë.

Lista e komiteve në kuadër të Kuvendit Komunal në Lipjan

Komiteti për Politikë dhe Financa			Komiteti për Komunitete		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik /komuniteti
1	Vlora Limani-Hajnuni	LDK	1	Naim Jahiri	LDK
2	Agron Hajdini	LDK	2	Xhavit Maholli	PD
3	Daut Azemi	LDK	3	Boban Jovanoviq	Serb
4	Xhevat Olluri	AAK/LDD/IQL	4	Avdush Banushi	ashkalinj
5	Hajrie Salihu	AAK/LDD/IQL	5	Skender Bikliqi	Turk
6	Blerim Gashi	AKR	6	Selvana Pandiq	Kroate
7	Arben Bahtiri	LDK	7	Ferat Gashi	Romë
8	Zoran Cirkoviq	G.I.Srbska	8	Milotin	Malazezë
9	Florent Hoxha	PDK	9		
10	Nazmi Krasniqi	PDK			
11	Petrit Kelmendi	PDK			
Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm			Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1		PDK	1	Albulena Gashi	AKR
2		PDK	2	Mërgim Krasniqi	AAK/LDD/IQL
3		PDK	3	Arton Retkoceri	LDK
4	Ragip Mehmeti	LDK	4	Muhamet Shabani	LDK
5	Fadil Sylejmani	LDK	5	Eqrem Haziri	LDK
6	Afrim Bahtiri	AAK/LDD/IQL	6	Ibrahim Kryeziu	VV
7	Rabit Konjufca	VV	7		PDK
8	Hafir Rashiti	PSD	8		PDK
9	Nazmi Gashi	PD	9		PDK

Komiteti për Shëndetësi			Komiteti për Arsimit		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1	Ukë Kryeziu	AAK/LDD/IQL	1	Nehat Terpeza	LDK
2	Haxhi Bytyqi	LDK	2	Zethane Seferi	LDK
3	Labinot Shahni	LDK	3	Skender Ademi	LDK
4	Sokol Shala	LDK	4		PDK
5	Bardhyl	AKR	5		PDK
6	Mergim Oruqi	PSD	6	Ahmet Dedushi	AAK/LDD/IQL
7		PDK	7	Edita Gashi	VV
8		PDK	8	Afrim Miftari	AKR
9		PDK	9	Bahtir Bahtiri	AAK/LDD/IQL

Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2015:

- Raporti i punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale për vitin 2014,
- Raporti i Buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve si dhe planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2014,
- Raporti i Buxhetit të Alokuar dhe Shpenzimi në Bazë të Burimit të Mjeteve të Kategorive Ekonomike dhe Programeve për Tremujorin e vitit 2015 Për Komunën e Lipjanit.

Lista e rregulloreve dhe planeve komunale të miratuar gjatë vitit 2015:

- Rregullore për Taksat Komunale.
- Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Buxheti i Komunës
- Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane.

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2015:

- Vendim për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.
- Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2013 dhe 2014 në vitin 2015.
- Vendim për plotësimin e Vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të pakujtueshme të Komunës 15Nr.464-40375/2014,
- Vendim për plotësimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri shoqërore e KK Lipjan ,KBI (Këshillit të Bashkësisë Islame) për Xhaminë e Fshatit Gadime e Epërme 15Nr.464-40387/2014,
- Shqyrtimi i propozim Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare,
- Vendim i dytë për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
- Vendim për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëfinancim në Implementimin e Projektit – Rregullimi i Hapësirave Publike në Qytetin e Lipjanit.
- Vendim për Organizimin e Zgjedhjeve për Zgjedhjen e Këshillave Kryetarëve të Këshillave të Lokalitetit.
- .

NOTIMI I PËRGRHITHËM

Kuvendi i Komunës së Lipjanit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (LDK, PDK AAK-LDD-IQL, VETËVENDOSJE, AKR, PD ,PSD dhe G.I.SRPSKA).

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendit komunal të Lipjanit Monitoruesit e YAHR-it kanë përcjellë të gjitha seancat e kuvendit të komunës së Lipjanit gjatë periudhës Janar – Maj 2015. Për më tepër, monitoruesit e YAHR-it kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga nëntë kategoritë e poshtëshënuara si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

YAHR-i në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në kategoritë e paraqitura në vijim:

1. Propozim për rend dite
2. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
3. Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve
4. Inicimi i çështjeve
5. Amandamentimi i legjislacionit
6. Inicimi i rregulloreve
7. Pyetjet parlamentare
8. Mungesa në seanca
9. Gjuha joparlamentare

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 14-17, në bazë të fletënotimit për se cilin deputet:

- Vërejtje: përkatësia e politike e deputeteve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të deputeteve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh, se ka pasur lëvizje të shumta dhe nuk kemi qartësi të plotë të përkatësisë politike.

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamentimi i legjislacionit	Inicimi i rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
FLORENT HOXHA	PDK	0	44	5	5	0	0	25	0	0	79
PETRIT KELMENDI	PDK	0	28	0	0	0	0	5	0	0	33
RAGIP ZEJNULLAHU	PDK	0	8	0	0	0	0	0	-1	0	7
NAZMI KRASNIQI	PDK	0	20	0	5	0	0	10	-1	0	34
ENVER KOZHANI	PDK	0	8	2	5	0	0	10	0	0	25
FERIZ HASANI	PDK	0	16	0	0	0	0	5	0	0	21
ALI STUBLLA	PDK	0	4	0	0	0	0	5	-1	0	8
VALBONA SHILLOVA	PDK	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9
BURBUQE ILAZI	PDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
VLORA BUJA	PDK	0	4	0	5	0	0	0	0	0	9
LABINOT SHAHINI	LDK	0	16	4	0	0	0	0	0	0	20
NEHAT TERPEZA	LDK	0	4	3	0	0	0	5	0	0	12
DAUT AZEMI	LDK	0	0	1	5	0	0	15	0	0	21
AGRON HAJDINI	LDK	0	16	2	0	0	0	0	0	0	18
ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Youth Association for Human Rights

NAIM JAHIRI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
VLORA LIMANI-HAJNUNI	LDK										
BURBUQE FAZLIU	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LINDA SHAHINI	LDK	0	8	0	0	0	0	5	0	0	13
XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	0	24	1	0	0	0	0	0	0	25
RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	0	8	0	5	0	0	10	0	0	23
HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	0	4	0	5	0	0	0	0	0	9
ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	0	16	0	0	0	0	5	0	0	21
EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	2	12	0	0	0	0	5	0	0	19
BLERIM GASHI	AKR	0	32	1	5	0	0	20	0	0	58
ALBULENA GASHI / ADELINA KRASNIQI	AKR	0	0	1	0	0	0	0	-1	0	0
XHAVID MAHOLLI	PD	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
RAMIZ QIRIQI	PSD	0	24	0	5	0	0	10	0	0	39
ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	0	0	0	0	0	0	10	0	0	10

Deputet aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve

	Deputeti	Subjekti politikë	pikët		Deputeti	Subjekti politikë	pikët
1	FLORENT HOXHA	PDK	79	16	NEHAT TERPEZA	LDK	12
2	BLERIM GASHI	AKR	58	17	ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	10
3	RAMIZ QIRIQI	PSD	39	18	VALBONA SHILLOVA	PDK	9
4	NAZMI KRASNIQI	PDK	34	19	VLORA BUJA	PDK	9
5	PETRIT KELMENDI	PDK	33	20	HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	9
6	ENVER KOZHANI	PDK	25	21	ALI STUBLLA	PDK	8
7	XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	25	22	RAGIP ZEJNULLAHU	PDK	7
8	MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	23	23	BURBUQE ILAZI	PDK	4
9	FERIZ HASANI	PDK	21	24	UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	4
10	DAUT AZEMI	LDK	21	25	XHAVID MAHOLLI	PD	4
11	ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	21	26	ARTON RETKOCERI	LDK	0
12	LABINOT SHAHINI	LDK	20	27	NAIM JAHIRI	LDK	0
13	EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	19	28	BURBUQE FAZLIU	LDK	0

14	AGRON HAJDINI	LDK	18	29	RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0
15	LINDA SHAHINI	LDK	13	30	ALBULENA GASHI / ADELINA KRASNIQI	AKR	0

Pjesëmarrja e subjekteve politike të Kuvendit në diskutime nga seanca 14-17, në bazë të fletë-notimit:

Subjekti politik	Propozim për rend dite			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare			Mungesa në seanca		
	Piket	%																
PDK	0	0	%	35	44.87	%	7	35	%	4	44.44	%	1 3	43.33	%	3	75	%
LDK	0	0	%	11	14.10	%	1 0	50	%	1	11.11	%	5	16.67	%	0	0	%
AAK-LDD-IQL	0	0	%	10	12.82	%	1	5	%	2	22.22	%	2	6.67	%	0	0	%
VV	1	10	%	7	8.97	%	0	0	%	0	0.00	%	2	6.67	%	0	0	%
AKR	0	0	%	8	10.26	%	2	10	%	1	11.11	%	4	13.33	%	1	25	%
PD	0	0	%	1	1.28	%	0	0	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0	%
PSD	0	0	%	6	7.69	%	0	0	%	1	11.11	%	2	6.67	%	0	0	%
G.I.SRPSKA	0	0	%	0	0	%	0	0	%	0	0.00	%	2	6.67	%	0	0	%


TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Janar –Maj 2015, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.


Deputetet më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: FLORENT HOXHA PDK 79 pikë, BLERIM GASHI AKR 58 pikë, RAMIZ QIRIQI PSD 39 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 34 pikë, PETRIT KELMENDI PDK 33 pikë, ENVER KOZHANI PDK 25 pikë, XHEVAT OLLURI AAK-LDD-IQL 25 pikë, MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI AAK-LDD-IQL 23 pikë, FERIZ HASANI PDK 21 pikë, DAUT AZEMI LDK 21 pikë, ARBEN BAHTIRI VETËVENDOSJE 21 pikë, LABINOT SHAHINI LDK 20 pikë, EDITA GASHI VETËVENDOSJE 19 pikë, AGRON HAJDINI LDK 18 pikë, LINDA SHAHINI LDK 13 pikë, NEHAT TERPEZA LDK 12 pikë, ZORAN CIRKOVIC G.I.SRPSKA 10 pikë, VALBONA SHILLOVA PDK 9 pikë, VLORA BUJA PDK 9 pikë, HAJRIJE SALIHU AAK-LDD-IQL 9 pikë, ALI STUBLLA PDK 8 pikë, RAGIP ZEJNULLAHU PDK 7 pikë, BURBUQE ILAZI PDK 4 pikë, UKË KRYEZIU AAK-LDD-IQL 4 dhe XHAVID MAHOLLI PD 4 pikë,

Deputete më pasivë të ashtuquajtur “Shikues” janë:, **ARTON RETKOCERI LDK, NAIM JAHIRI LDK, BURBUQE FAZLIU LDK, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL dhe ADELINA KRASNIQI (ALBULENA GASHI) AKR** të gjithë me 0 Pikë.

Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave




Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve



INICIMI I ÇËSHTJEVE

Gjatë kësaj periudhe kemi një angazhim konkret të deputeteve të kuvendit komunal në Komunën e Lipjanit lidhur me iniciimin e çështjeve. Subjekti i PDK-së gjatë kësaj periudhe i ka ngritur 4 çështje apo 44.44 %, AAK-LDD-IQL i ka ngritur 2 çështje ose 22.22 %, nga një çështje e ngritur Vetëvendosja , LDK-ja, AKR-ja dhe PSD-ja.



PYETJET E PARLAMENTARE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Qershor-Nëntor 2014, kemi vërejtur një trendë i rritjeve të pyetjeve drejtuar ekzekutivit të komunës së Lipjanit dhe kanë qenë për këtë periudhë gjithsej 30 pyetje nga të cilat 13 pyetje i kemi nga deputetet e PDK-së 43.33 %, statistikën me të plotë e kemi në tabelën e më poshtme.

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 13-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 30. 01. 2015:

Florent Hoxha, ne grupi parlamentar i PDK-së më herët kemi ngritë disa shqetësime dhe nuk kemi marr përgjigje, andaj është mirë që të na ktheni përgjigjet me shkrim për shqetësimet që kemi parashtruar si që është për pronën te tregu i kafshëve se kujt i është dhënë kjo pronë.

Zoran Çirkoviç, kërkoi që të rregullohet ndriçimi publik prej Shtëpisë së Kulturës deri te Kisha dhe kjo nuk është bërë, **Nazmi Krasniqi**, shprehu shqetësimin pse askush gjerë me tani as ekzekutivi as legjislativi nuk kanë paraqitë asnjë informatë apo raport për gjendjen në arsim e gjithashtu as për suksesin e nxënësve për gjysmë vjetorin e parë.

Ramiz Qeriqi, ngrit shqetësimin e mos realizimit të disa kërkesave në vitin e kaluar :

- Që në Sheshin “Adem Jashari” të ngritet një monument që simbolizon Dëshmorët dhe Martirët e Luftës.
- Që Veteranët e luftës dhe skamnorëve tu jepen në shfrytëzim disa banesa që janë në pronësi të komunës.
- kërkoi që të mirëmbahen monumentet historike.
- kërkoi që të caktohet një lokal muze historik.

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 14-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 27.02. 2015:

Ramiz Qeriqi: pyeti se pse nuk jemi përfaqësuar edhe ne nga subjektet më të vogla në seminar në Tiranë dhe dëshiroj të dijë se çfarë kritere kanë qenë që nuk jemi përfshi.

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 15-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 07.04.2015:

Florent Hoxha, kërkoi që rruga për fshatin Divjakë të shtrohet dhe ngriti problemin në rrugën “Qamil Olluri” para një viti është hapur një gropë nga kompania e “Ujësjellësit” andaj kërkoi, nga Drejtori i Drejtoria për Shërbime Publike, që të shikon mundësin e rregullimit, me që automjetet po pësojnë në ato rrugë.

Blerim Gashi: ngriti çështjen se si përfaqësues të zgjedhur dhe si bartës i kërkesave të qytetarëve dhe në mbledhjen e kaluar ka qenë një kërkesë që në rend dite të hynë për shqyrtim procesi i legalizimit për objekte kurse sot kjo pikë nuk është në rend dite. Ndërsa, pyetja e dytë ishte lidhur çështjen e objektit për raste sociale, i cili është dhënë me koncesion qe 4 vite, Pyetja e tretë ishte se në fillim të vitit ka filluar procesi për zgjidhjen e problemit të qeneve endacak dhe pse nuk ka ndonjë lëvizje.

Merita Zeqiri: paraqiti shqetësimin e saj për mungesën e vijave të bardha nëpër rrugët e fshatrave, gjithashtu kërkoi që të shqyrtohet mundësia e shtruarjes së trotuareve për fshatrat Topliqan i Vjetër, Hallaqi i Madh, Hallaqi i Vogël, Rufci i Ri, Gllogovc dhe Ribari i Vogël. me që në këto rrugë është qarkullim i madh i automjeteve dhe është rrezik për udhëtar. Pastaj kërkoi nga drejtori i arsimit që të ndërpritet bashkëpunimi me RTK-në me programin 1.2.3 “Fillo” me që kemi vërejtur shumë padrejtësi në atë emision.

Daut Azemi: parashtoi dy pyetje, e para pse po vërshohet nga uji shkolla “Ismail Luma”, dhe e dyta pse nuk po intervenohet me asfaltimin e rrugës Lipjan- Janjevë deri në kryqë .

Enver Kozhani: Pyeti lidhur me ndaljen e mëditjeve të subjektit politikë të tij?

Nehat Tërpeza, ngriti çështjen e banorëve të fshatit Bregu i Zi për shkak të mosfunksionimit të kanalizimit ku ujërat e zeza kanë dalë në sipërfaqe dhe kërkoi që të bëhet zhavorrimi i rrugëve në fshat.

Zoran Qirkoviq: kërkoi të bëhet zhavorrimi i rrugës para Shkollës Filllore “Vëllezërit Aksiq”.

Feriz Hasani: kërkoi që të shqyrtohet mundësia e rregullimit të shtretërve të lumenjve .

Arben Bahtiri: pyeti drejtorin e arsimit lidhur me shkollën e re të gjimnazit, se kur do të përfundon .

Edita Gashi: pyeti se ka është bërë me kërkesën për zëvendësimin e anëtarit në KPF?

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 16-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 30.04.2015:

Linda Shahini: kërkoi që Komuna në kuadër të mundësive të merr masa për pastrimin e objekteve të Minierës së Magnezitit në Magurë .

Ali Stublla: pyeti për shkollën në Banullë se kam bërë kërkesë qe 1 muaj për pranimin teknik të kësaj shkolle dhe pse nuk po bëhet pranimi teknik?


Florent Hoxha: ngriti disa shqetësime për qytetarët e Gadimes të cilët janë mirënjohës për ndërtimin e urës e cila lidh edhe Gadimen e Epër por ata kërkojnë që në kuadër të mundësive të ngritët edhe një urë lidhëse për këmbësor nga ana e Tashollëve me Shpellën. Shqetësim i dytë ishte i qytetarëve të fshatit Leletiq për ujërat e zeza të cilat dalin mbi sipërfaqen tokësore. Shqetësimin e tretë e ngriti për shkollën filllore në Mirenë, se shkolla punon në 3 ndërrime. Po ashtu, ngriti çështjen tjetër me ujësjellësin në Shalë ku një person nga burimi ku merret uji edhe pse nuk është pronë e tij po pengon marrjen e ujit andaj kërkoj që të merren masa.

Enver Kozhani: ngriti shqetësimin e shumicës së lokaliteteve në Komunën e Lipjanit për shkak të krijimit të deponive të egra .

Hajrije Salihu: kërkoi nga Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport që të funksionalizimet shtëpia e atë Shtjefën Gjeqovit dhe po ashtu pati shqetësim lidhur me organizimin e ditës përkujtimore, i cili organizim ka qenë nën nivel.

Valbona Shillova: ngriti shqetësimin e qytetarëve të fshatit Topliqan për shkak të deponisë së krijuar afër fushës së sportit për të cilën kërkoi që të pastrohet – hiqet kjo deponi.

Blerim Gashi: pyeti lidhur mos marrjes se përgjigjeve nga pyetjet e bëra nga mbledhjet e kaluara pasi që jemi përfaqësues të qytetarëve dhe kemi obligim që të paraqesim shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve.




AMANDAMENTIMI I LIGJISLACIONIT

Rreth amandamentimit të rregulloreve të ndryshme të kuvendit komunal gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur edhe pse janë aprovuar tri projekt rregullore.

MUNGESA NË SEANCA

Në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në pesë seancat e mbajtura në periudhën Janar - Qershor 2015 kemi mungesë të deputeteve në dy seanca nga një dhe në një seancë dy deputet.

Mungesa në seanca



PROPOZIM PËR REND DITE

Është shumë interesante që krahasim me periudhat e kaluara, kësaj radhe kemi vetëm një propozime konkrete për rende dite nga përfaqësueses nga Lëvizja Vetëvendosje rreth çështjes së përfaqësimit të këtij subjekti politikë në Komitetin për Politikë dhe Financa..

Propozim për rend dite

